
POSTIM ARKIVOR

Më 4 mars 1945 u ekzekutuan martirët At Daniel Dajani, At Gjon Shllaku e të tjerë

Gjyqi ndaj organizates "Bashkimi"



SEKSIONI

1944-1950

PERIUDHA

1945 - 1976

Gjatë dhjetorit 1945, autoritetet komuniste zbuluan në Shkodër organizatën “Bashkimi Shqiptar”, të drejtuar nga seminaristi Mark Çuni, e cila ishte shfaqur përmes trakteve antikomuniste. Si pasojë, u arrestuan edhe Atë Giovanni Fausti dhe Atë Daniel Dajani, si eprorë të seminarit. U ndaluan gjithësej 39 persona, në atë që konsiderohet goditja e parë e organizuar ndaj klerit katolik në Shqipëri. Gjyqi u zhvillua në kinema “Rozafati”, ku të pandehurit u akuzuan për bashkëpunim me fashizmin dhe sabotim të rezistencës. Nga 39 të arrestuarit, 7 u dënuan me vdekje dhe u pushkatuan më 4 mars 1946 pranë Varrezave të Rrmajit në Shkodër.

PERMBAJTJE #1

Bashkimi Shqiptar” dhe goditja e parë ndaj klerit katolik në Shqipëri (1945): Rasti i dosjes së Gjovalin Zezajt

Gjatë dhjetorit të vitit 1945, autoritetet e regjimit komunist zbuluan në Shkodër organizatën “Bashkimi Shqiptar” që drejtohej nga i riu seminarist Mark Çuni . Organizata ishte shfaqur nëpërmjet disa trakteve antikomuniste të lëshuara në qytetin e Shkodrës. Për këtë arsye, u arrestuan, gjithashtu, si përgjegjës Atë Giovanni Fausti dhe Atë Daniel Dajani si eprorë dhe profesorë të seminarit. Gjithsej u arrestuan 39 persona. Kjo do të ishte e para goditje e organizuar ndaj klerit katolik në Shqipëri. Dosja Hetimore Gjyqësore për Gjovalin Zezaj, një ndër të dënuarit, e ruajtur në Arkivin e Sigurimit të Shtetit, Fondi nr. 1, HGJ 1976, dosja nr. 1069.A, me 129 faqe, është hapur më 24.07.1959 dhe përmban materiale hetimore dhe gjyqësore, duke përfshirë edhe vendime dënimi me vdekje për At Daniel Dajanin, Gjon Shllakun, At Giovanni Faustin, Gjovalin Zezajn, Mark Çunin dhe të tjerë të përfshirë në këtë proces. Ky dokument përfaqëson një burim arkivor të rëndësishëm për rikonstruktimin e ngjarjeve dhe procedurave gjyqësore që lidhen me çështjen në fjalë.

PERMBAJTJE #2


Dosja hetimore dhe ridenimi i Gjovalin Zezajt në kuadër të çështjes ‘Bashkimi Shqiptar

Dosja e lidhur me çështjen e organizatës “Bashkimi” (gjyqi i 31 janarit 1946), nuk i përket drejtpërdrejt procesit gjyqësor të kësaj organizate, por përfaqëson dosjen e ridenimit të vitit 1959 ndaj Gjovalin Zezajt. Dosja e Hetuesisë nr. 1069.A, e hapur më 24.07.1959 dhe e përfunduar më 15.09.1959, lidhet me akuza për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor, për shprehje kundërshtimi ndaj regjimit dhe për dëgjim e përhapje lajmesh nga radiot e huaja. Vendimi u mbështet në dëshmi dhe materiale hetimore dhe solli dënimin me 5 vjet burg. Gjovalin Zezaj, i lindur në Shkodër më 1928, ishte ndër studentët e parë të arrestuar në 1945 për organizatën “Bashkimi Shqiptar”. Ai u gjykua me 39 të pandehur dhe më pas u dënua sërish në 1959. Pas lirimit, përfundoi shkollën dhe më vonë u angazhua në shoqatat e ish të përndjekurve deri në vdekjen e tij në 2020.

MEDIA #1

Procesi gjyqësor i vitit 1946 ndaj organizatës ‘Bashkimi Shqiptar’ dhe dënimet e rënda ndaj klerit katolik në Shkodër

MEDIA FAQE #1



Republika Popullore e Shqipnis
Prokuroria Kushtetare
Gjykata e Larte Gjyqesor Ushtarake
Dosja Nr. 1 Aktesh 21
Nr. 1 Vendimit 7

V.P.L.P.
Nr. 1 Akt-Gjykimit

A K T - G J Y K I M

M'emer te Popullit Shqiptare

Keshilli Gjyqesor Ushtarak i Qarkut Shkoder i formuar prej:

Kryetar — Tenger Mustafa Iljazi
Anetar — Kapiten Nesim Demali
Anetar — Aspirant Tonin Gjoni


Tue qene gati Prokurori ekuu Kapiten Arsenit Cela dhe Se
teri Akrobem Asdil Deutoj.-
Ne proçedimin penal te zhvilluar prej Prokurorise se kesaj
kate,

K U N D R A

1. Klovenal Antonio Dedaj, 1 biri
2, Dedaj Ukesh Dedaj, 1 biri
drinopë, profesor dhe Nektor i Seminarit Botuar
shkoder, i pa martuar
3) Mark Ukaj Gjuli, 1 biri
shatl, student Universitar ne Seminarin te Shkoders, i pa martuar,
duar.-
4) Nom Loro Shiloku, 1 biri
dres, dhe profesjon ne Lyceum Françesk te shkoders, i pa martuem,
em.-
5) Gjergj Mat Biçi, 1 biri
ka e Ndlotit, Student Universitar ne Seminarin Jusuit te Shkoders,
tuar, i pa demuem.-
6)Gjon Prel Shiloku, 1 biri
shkodra, student Universitar ne Seminarin Jesuit, i pa martuem,
7)Nikoc Gjeloseh Vata, 1 biri
nga Gurea Shlotit, Student Universitar ne Seminarin e Jesuiteve
i pa martuem, i pa demuem.-
8)Preng Ukesh Lesaj, 1 biri
Kulgeri Leshit, student Universitar ne Seminarin e Jesuiteve
i pa martuem i pa demuem.-
9)Pjeter Gjok Hajdlli, 1 biri
nga Koltoja, student Universitar ne Seminarin e Jesuiteve
martuem, i pa demuem,
10) Imiro Kuko Petrovic, 1 biri
Mapunea, i pa martuar, i pa demuar, nga shkodra.-
11) Arnesto Gjok Nrenu, 1 biri
pa martuem i pa demuem, student nga shkodra.-
12) Gjeloseh Lulash Bajraktari, 1 biri
vjeç 20, i pa martuem, i pa demuem, Ish Oficer dhe tash Nektor ne Spi
Ushtarak, nga Mirdeshi Shoshit Dukagjinit.-
13) Lulgi Nikoc Kolaj, 1 biri
martuem, i pa demuem, student nga Shkodra.-
14) Gjeloseh Ndl Marku, 1 biri
pa martuem, i pa demuem, Profesor, nga Kastrati dhe banuem ne shkoder
15) Sef Gjlm Skrulte i biri


Procesi gjyqësor i vitit 1946 ndaj organizatës ‘Bashkimi Shqiptar’ dhe dënimet e rënda ndaj klerit katolik në Shkodër

MEDIA FAQE #2




Procesi gjyqësor i vitit 1946 ndaj organizatës ‘Bashkimi Shqiptar’ dhe dënimet e rënda ndaj klerit katolik në Shkodër

MEDIA FAQE #3




Procesi gjyqësor i vitit 1946 ndaj organizatës ‘Bashkimi Shqiptar’ dhe dënimet e rënda ndaj klerit katolik në Shkodër

MEDIA FAQE #4




Procesi gjyqësor i vitit 1946 ndaj organizatës ‘Bashkimi Shqiptar’ dhe dënimet e rënda ndaj klerit katolik në Shkodër

MEDIA FAQE #5



Procesi gjyqësor i vitit 1946 ndaj organizatës ‘Bashkimi Shqiptar’ dhe dënimet e rënda ndaj klerit katolik në Shkodër

MEDIA FAQE #6



Procesi gjyqësor i vitit 1946 ndaj organizatës ‘Bashkimi Shqiptar’ dhe dënimet e rënda ndaj klerit katolik në Shkodër

INFORMACION

Procesi gjyqësor i vitit 1946 ndaj organizatës ‘Bashkimi Shqiptar’ dhe dënimet e rënda ndaj klerit katolik në Shkodër

FONDI	1
STRUKTURA	-
DOSJA	1069-A
	1945-1976
	129
DATA E KRIJIMIT	15.12.1944
GJUHA	Shqip
LLOJI I DOKUMENTIT	Vendim i Dënimit
KRYETAR I TRUPIT GJYKUES, (GJYKATA E LARTË USHTARAKE)	Aranit Cela
TRUPI GJYKUES	Kryetar: Toger Mustafa Iljazi Anëtar: Kapiten Nafiz Belshi Anëtar: Aspirant Tonin Nikolla

HAPËSIRA GJEOGRAFIKE	Shkodër
TIPOLOGJIA E DOSJES	Hetimore -Gjyqësore

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.